

INTERVISTË ME XHEVDET XHAFËN

Prishtinë | Data: 7 dhjetor, 2016

Kohëzgjatja: 40 minuta

Të pranishëm:

- Xhevdet Xhafa (I intervistuari)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Noar Sahiti (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Erëmirë Krasniqi: Zoti Xhafa, a mundesh me na tregu për kujtimet tua të hershme, rrethin ku jeni rritë edhe familjen në të cilën keni jetu?

Xhevdet Xhafa: Po. Si fillova, me folë, me u rritë edhe fillova me vizatu. Më kujtohet mirë, pranvera e madhe e vitit 1941, Lufta e Dytë Botërore. Siç e dijmë, ish—Jugosllavia kapitullon ndaj Gjermanisë. Me kapitullimin e ish—Jugosllavisë, edhe gjysma e tokave Shqiptare shlirohet nga okupimi gati 30 vjeçar, serbo—sllav. Më kujtohet në Pejë ishte një festë e madhe, fillon arsimimi në gjuhën Shqipe. Me dhjetëra mësues vijnë nga Shqipëria e sotme, për të ndihmuar arsimin shqip në Kosovë, në trojet e shlirume.

Unë isha në klasën e parë, në klasë ishim shumë nxanës, ne nxanësit kishim nga dy fletore. Unë e doja shumë vizatimin. Para se të filloj të mësoj në shkollë, kom vizatu nëpër muret e lagjes. Edhe në këto dy fletore, fillova me vizatu. Një ditë mësuesi më tha, “Këto fletore janë për me shkru”, unë i thashë, “Unë e dua vizatimin”. “Ani, po ta mundësoj faqen e parë të fletës për me shkru, e faqen e dytë vizato”. Unë e ndigjova edhe fillova ashtu si më udhëzoi. Mirëpo, ato shenjat e lapsit u dukshin edhe faqen e parë të fletës. Heshti mësusi...

Mas dy—tri ditëve hyj në klasë, drejt vjen te banka ime, me veti ka sjellë tri fletore edhe më thotë, “Djalo, ndigjo! T’i kom pru tre fletore, dy fletore jonë për me shkru, në këto dy fletore jo me vizatu, qe këtë fletore pa vija munësh me vizatu”. Edhe unë, shumë u gzova, fillova në atë fletore pa vija me vizatu, gjithçka ça kishna afër. Dëshira ime ishte me vizatu kafshë shtëpiake, e kisha afër. Çdo familje, në lagje dhe në qytezë, kishin ka një, dy, tre, kafshë, se gjendja sociale te banorët ishte shumë e randë... ajo gjendje e randë sociale edhe është përjetu në familjen tonë.

Mirëpo, me kalimin e kohës, ai farë shlirimi për shqiptarët nuk pati jetë të gjatë. U kriju Jugosllavia e re. Në Pejë hapet një dyqan, me shkronja të mdhaja shkrunte Knjižara [Libraria]. Unë e blej një bllok vizatimi, ku shkrunte në faqen e parë Blok broj jedan [Bllok numër një]. Domethonë ishte pas lufte unë thom, dikush thotë pas shlirimit, unë me këtë mendim nuk pajtohem. E blej një bllok t’vizatimit pra, një parë ngjyra uji, me një brushë të vogël filloj me pikturu gjithçka ça kishna afër. Dal në lagje filloj me

pikturu, disa shpija të vjetra, të vogla, disa dyrë të mëdha prej drunit, ma vonë dal në natyrë. Në Pejë e kemi një bregore që thirret Tabje, ajo gjatë tanë vitit është e bukur, natyra e zbukuron. Mandej kam shku e kom vizatu grykën e Rugovës, Patriashinë e Pejës si objekt fetar... edhe disa objekte tjera.

Mirëpo, te unë ishte një preokupim, si ta kuptoj natyrën e gjallë, figurën e njeriut, gjymtyrët, fizionominë e kokës të njeriut... me një strejcë, në krahë me disa fleta maqine, e mjete tjera ndihmëse, filloj të shetis në disa tregje të Pejës. Ma së shpeshti jom dalë në tregun e gjelbërt. Nga fshatrat në ditë pazari i bijshin prodhimet bujqësore me do kosha të mëdha e të vogla përplot me artikuj ushqimor.

Vetë pronarët ishin veshë me ato veshje tradicionale, që ishin aktuale për vitet '50—ta, '60—ta. Edhe unë, me shpejtësi, me kënaqësi, fillojsha shpejt e shpejt, me realizu me vizatu atë pamje të bukur. Mandej shpesh kom shku edhe në stacionin e autobusave... aty pak ma vështirë e kom pasë me vizatu, pse udhëtarët gjithnjë lëvizshin. Mirëpo, pak simbas kujtesës pak simbas natyrës, ato vizatime që i bojsha ishin si një lloj kroki.¹

Shumë ma mirë e kom ndi vetën kur kam shku në stacionin e trenit, kam shku dimnit, verës, në shi, në borë edhe shpesh udhëtarë të kom gjetun me orë të tana t'u e prit trenin, e udhëtarët e lodhun i shifsha grumbuj, të shtrimë në pozita të ndryshme. Për mu ishte joshëse, çdo pozitë e udhëtarëve, e afërt për m'i vizatu... edhe kështu gjashtë, shtatë vite të punës sime, aktiviteteve të lira, për mu ishte e mirëseardhun. Jo vetëm që e kuptova natyrën e gjallë, figurën e njeriut, gjymtyrët, por u shtua edhe guximi i shprehjes, guximi i sinqertë, guximi natyral, pa përdor ato medikamente stimuluse siç dje dhe sot disa artistë i përdorin.

Isha gjithnji jo i qetë si artist... fillova të mësoj për historinë e kombit shqiptar nga fjalët e gjalla, ato mendime më inspiruan. Mendoja si ta kuptoj, ma mirë të mishnohesha me njeriun, me vetveten, me art ta ndihmoj. Vendosa mos të jem mo rob i ngjyrës, por të jem rob i vetit, i njeriut të këtij trolli. Fillova të inspirohna me atë që kom ma së afërmi, me arkitekturën autoktone, sidomos të Dukagjinit, po thom Dukagjinit jom përcaktuar pse kom lind në Dukagjin edhe jom rritë në Dukagjin.

Kom shku shpesh me vizitu arkitektura të ndryshme, në qytete të ndryshme sidomos ma së shumti jom përcaktu për Gjakovë, se aty ka qenë një arkitekturë pak a shumë e mbyllun, mirëpo me vlera arti, arkitektura drejtpërdrejt lidhet me atë të Gjakovës, me ambientin, njeriun, me natyrën. Kom shku edhe në Prizren, aty arkitektura pak ma jo autoktone, siç e dijmë Prizreni ka qenë urë lidhëse e popujve të Ballkanit, e aty ka qenë normale që kanë ndërhy disa kultura tjera, mirëpo edhe ato kultura qe kanë ndërhy jonë mishëru me arkitekturën vendore. Edhe kështu edhe sot arkitektura Prizrenit është madhështore, lidhet drejtpërdrejtë me natyrën, me njeriun, me njerëzit.

Isha gjithnji në një lloj depresioni. Mandej kemi një arkitekturë edhe ma të vlefshme, ma jetëgjatë, ato jonë kullat e Dukagjinit, si për shembull kullat e Strellcit, Lubeniqit, Isniqit e shumë objekte tjera ku

¹ *Croquis*, skicim i figurës trupore.

kanë jetu shqiptarët e ku jetojnë shqiptarët, që kanë edhe vlera arti. Po ta paraqesim, paraqitet një njeri me veshje tradicionale afër kullës, Dukagjinit, kemi me pa që këto dy fizionomi bashkohen, kemi me pasë një fizionomi... mandej jom inspiru edhe jom frymëzu edhe i kom përdor folklorin që e kemi të pasun, të sinqertë. Siç e dijmë folklori shqiptar është përcjell me shekuj, gjeneratë mas gjenerate te popullata shqiptare.

Larat, dekorimet që jonë dhonë në veshjet tradicionale jonë dhonë nga mendja e shnoshë, e sinqertë e njeriut. Në këto lara, siç e dijmë prezent është ose dominuse ngjyra e zezë, kjo ngjyrë drejtpërdrejtë lidhet me fizionominë e kombit shqiptar, është ngjyrë bindëse, ngjyrë e fortë, ngjyrë tradicionale. Kom fillu të mirrem edhe me sport, nuk e nijsha vedin mirë, s'isha i qetë... kur jom marrë me gjimnastikë, ma shumë me vrapim (kollitet) rruga ma e dashun e vrapimit për mu ka qenë rruga e Grykës së Rugovës. Përpjetëzës të kësaj rrugës vrapojsha ma ngadale, t'u u kthy shumë ma shpejt, teposhtëzë kam të shkojshin vet.

T'u i shku kësaj rruge e t'u u kthy, gjithnji mendja dhe sytë më shkojshin kah shkambijtë e Grykës të Rugovës, atë madhështi vetëm natyra ka mujtë me kriju edhe me na lanë. Nga ato shkambij edhe une kom marrë diçka dhe e kom paraqitur në veprat e mija. Mua natyra më ka ndihmu të mirrem me art, natyra më ka udhëzuar ta doja artin. Preokupimet e mija i kom shprehur me lehtësi, me mjete që i kom pasë afër, rreth e përçark i kom pasë... kom jetu me to, e njoh mirë fizionominë e tyre edhe drejtpërdrejtë me ato mjete unë kom shpreh ndjenjat, shqetësimet e mija. U mundova me pak fjalë me dhonë një grimcë biografie të veprimtarisë sime, artistike. Faleminderit!

Erëmirë Krasniqi: Zoti Xhafa a mundesh me na tregu kur je marrë ma s'pari, hapat e parë kshtu ma formal që kanë qenë, edukimin ku e ke ba, a ka ekzistuar atëhere kjo Shkolla e Artit në Pejë?

Xhevdet Xhafa: Po, ka ekzistuar Shkolla e Artit në Pejë, u formu në 1948, une kom qenë gjenerata e pestë, ka qenë shkolla e fortë e artit bile në atë ish—Jugosllavi, ka qenë shkolla e dytë se kanë qenë një shtatë—tetë shkolla të mesme. Domethonë ka qenë Shkolla e Artit krejt ne aty kemi mësu, jo nga profesorat aq sa nga natyra. Natyra ka ndiku që ne të inspirohem ta thomë në mënyrë ma të sinqertë, ta shprehim atë diturinë tonë në pëlhurë.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë shkolle e pikturës ka qenë ajo, në atë kohë?

Xhevdet Xhafa: Ajo ka qenë pak shkollë e pikturës, në të vërtetë arti pak a shumë i kufizim, mirëpo ka qenë e fortë, që shumë gjenerata që kanë kry aty, sot jonë edhe kanë emra që përfaqësojnë artin kosovar. Ka qenë një shkollë pak a shumë me këtë kohën e sotme, klasike, mirëpo ka qenë shkollë e fortë, e qëndrueshme. Hapat e para pra i kom marrë aty, mandej meqenëse edhe aty ishte edukimi pak i kufizim, natyra ishte prezent... unë kishna, isha pak në moshë, kishna edhe unë fuqinë ma shumë diçka, mirëpo s'kishim guxim. Shkova në studime, Lublanë, qëllova te një profesor i mirë, fati nga

Gabrijel Stupica,² që e konsiderojshin atëhere intelektual në laminë e pikturës, italianët e kanë konsideru.

Edhe unë fillova m'u shliu. Çka di, m'u shpreh, profesori u habitke thojke, "Mirë, mirë, mirë". Një provokim ma kanë bo, "A mundesh me paraqitë natyrën si është?" Thojsha, "Po". Edhe kur e paraqita atë, ai më udhëzoi atëhere më lëshoi me punu, nuk m'kanë pengu fare se e dinte që kom një nerv arti, e dua artin. Edhe kështu fillova me marrë një guxim dalë ngadalë edhe fillova ato punët e mija. Vonë jom paraqitë me pikturat e mia, kom qenë i mbyllur i kufizum pak, se e kisha që më mungonte guximi m'u paraqitë në opinion.

Mirëpo, t'u ardhë kritikë të ndryshëm nga ish—Jugosllavia me pa çka po ngjanë në Kosovë, kur vishin te unë, "Mirë, mirë, mirë!" Edhe guximi te unë filloi edhe me u forcu. Asnjheri (kollitet) nuk kom marrë pjesë në konkurs, por gjithnji më kanë ftu në këto ekspozita, qoftë bienale, triennale ish—Jugosllave. Madje, po ashtu, në botën e jashtme kur kemi ekspozu, që ka organizu muzeu i Zagrebit apo Lublanës apo me grupe mu më kanë ftu. Edhe bota e jashtme kom pa aty këtu ose më ka tregu dikush që po shkrun gazeta, edhe mu më kanë veçu, tre, katër vetë, pesë vetë, dhetë vetë, në mes tyre edhe unë. Edhe tash te une fillon guximi edhe ma fortë.

Erëmirë Krasniqi: Zoti Xhafa qysh shkut në Lublanë në atë kohë, po mendoj kush ju shtyu, kush ju mbështeti me shku në Lublanë. A kishe mujt me na tregu çfarë stili në art ju kanë mësu atje?

Xhevdet Xhafa: Vendosa me shku në Lublanë, në Beograd as që kom provu me konkuru, shokët e mi gjithmonë kanë shku në Beograd, disa kanë pasë sukses, disa jo. Kom shku në Lublanë me qëllim sa ma rrallë m'u kthy në vendlindje (qesh), me qenë aty prezent, me punu, me dhanë krejt prej vetit, çka di, ato aftësitë e mija. Edhe aty erdha në çfarë shprehje që ma vlerësun. Bile edhe një moment ishte, në katër, pesë punime në rektorat, i kanë marrë me ia, për me pa kushdo që vjen prej musafirëve, me pa një art i pastërt. Mendimi im edhe tash thom, sot, po vlerësohet arti i sinqertë, po edhe risia, mirëpo i sinqertë edhe kuptohet vlere me qenë prezent.

Erëmirë Krasniqi: E kështu, kur u përhap si formë modernizimi në pikturë, po mendoj edhe në këtë shkollën e Pejës, a ju shtijshin me pikturu në stilin socio—realist, apo çfarë rryma ishin atëhere?

Xhevdet Xhafa: Shkolla e Pejës ka qenë një shkollë klasike, ishte natyra për me përshkru natyrën, edhe diçka ma tepër nuk lejojshin. E unë kisha vullnet me thonë se isha pak në moshë me thonë diçka ma shumë. Në një moment fillova diçka me thonë, ato që ma merrke mendja mirë, mirëpo nuk më lejun. E kur shkova në studime në Lublanë, gjeta një mirëkuptim, fillunë me më përkrah, e modernizmi ka fillu kahere, para një shekulli po...

² Gabrijel Stupica (1913-1990) u lind në Dragose, Sloveni. Ai ka studiuar në Akademinë e Arteve të Buukura në Zagreb. Arti i tij ka qenë i ndikuar nga një vizitë që kishte pasur në ekspozitën e Tizian në Venedik, më 1937 dhe një ekspozitë të kryeveprave të Prados në Gjenevë më 1939. Më 1946 ai bëhet profesor i rregullt i pikturës në Akademinë e Arteve të Bukura në Lublanë, e cila asokohe sa ishte themeluar.

Erëmirë Krasniqi: Në Kosovë?

Xhevdet Xhafa: Në Kosovë? Çka me thonë, ka fillu, po thom, ndoshta me mu pak (qeshë), edhe mosha është pak në pyetje. Unë ma tepër fillova me marrë guxim në shprehje, t'u u pa që arti im po duhet, po vlerësohet. Edhe këto bienalet, trienale që janë organizu ka dy here, tri here kom marrë pjesë, jom vlerësu lartë, mandej edhe në Cagnes—sur—Mer ka qenë ekspozita ndërkombëtare, 42—43 shtete kanë marrë pjesë, mua më është nda merita nacionale... shembull, në Austri arti bashkohor Jugosllav, dy vetë na kanë veçu, mua edhe një kroat.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e përshkrujshin punën tande?

Xhevdet Xhafa: Nji art, i pastërt, autokton, me vlerë nacionale.

Erëmirë Krasniqi: Jugosllavisë a të...?

Xhevdet Xhafa: Jugosllavisë edhe botës jashtme, qito mendime edhe botës jashtme, kritika... se për shembull drejtën me ju tregu, arti Jugosllav nuk ka nji peshë në botën e sotme, edhe e quajnë provincë. Mirëpo, qe, në Australi një kritik po shkrun në gazeta, këtu, “Mund t'i kalojnë kufijtë por veprat e Xhafës, e atij e atij...” tri katër vetë na përmendi.

Pjesa e Dytë

Xhevdet Xhafa: Unë jom inspiru nga njeriu ynë, nga historia si thashë nga folklori, arkitektura. Atë mendje të shnohtë që e konsideroj pak që e kom ma s'lehti natyra më ka ndihmu ta shprehi për art. Arti sot e përfaqëson nji popull, nji vend ma shpejtë se shkenca se ne jemi dikush por siç e dijmë gjithnji ka dominu okupimet, skamja edhe e ka ndiku që ne mos të shfrytëzojmë atë fuqi, atë fuqi me shfrytëzu.

Erëmirë Krasniqi: Zoti Xhafa, a ju është leju mrena Jugosllavisë sa keni qenë, a ju është leju me shpreh edhe qet' farë, qeto motivet ma nacionale?

Xhevdet Xhafa: Po, po

Erëmirë Krasniqi: Domethonë nuk keni pasë naj...

Xhevdet Xhafa: Jo, jo. Aty—këtu ka pasë reagime qysh po paraqitet nji kulturë e nji kombi. Ka pasë ndonji reagim, për shembull në Sarajevë mirëpo ato me nji farë marrëveshje në mes tyre hajde ta sulmojmë Xhafën. Punimet e tij janë nacionaliste, mirëpo vlera artistike ka qenë dominante edhe të drejtën me të tregu edhe ata që kanë kritiku, nuk ma kanë deshtë, artin tim nuk ma kanë deshtë ajo

prapë ka ecë. Edhe sot kom guxim me shprehë ma së lehti në art, atë mendje të shnoshë që e konsideroj që e kom, jom në gjendje me e shprehë në mënyrë të sinqertë edhe kuptohet me një kulturë që ne e kemi. Mirëpo, më tepër thom me atë mendje të shnoshë që e kemi edhe lehtë e shprehim në art. Kom pasë presione mos m'u pranu në fakulltet si mësimdhënës mirëpo vjen dej te ajo që inkuadrohna.

Erëmirë Krasniqi: Në cilin vit, a po na tregon kështu pak ma detajisht?

Xhevdet Xhafa: Po, '74—tën kom fillu me punu si pedagog. Kom qenë i afërt me studentë, është përkrahë metoda ime pedagogjike te studentët, u kuptuan ato aftësitë e mia se unë gjithnjë kom shku nga ajo që studenti shpejt të mëson, të pamvarësohet. Jo me ia lanë kohës se koha shpejtë po ecë edhe kështu që kom qenë i përpikët në mësimdhanje, kom qenë i afërt me studentë edhe sukseset e studentëve nuk kanë mungu.

Erëmirë Krasniqi: Me çka i mësojshit, çfarë historie të artit ua mësojshit, çka ish, çka ish...

Xhevdet Xhafa: Unë në përgjithsi në lidhje me histori figurative i mësojsha dhe thojsha, “Mirë o me u inspiru nga literatura, por jo drejtpërdrejtë me marrë diçka. Mos besoni dikujt që thojnë, ndonji profesor, duhet me qenë mjeshtër me ditë me vjedhë, se lehtë o me ditë me vjedhë”. Të rihtë në akademi jonë shumë të mençëm mirëpo atë mençuri nuk dijnë me shfrytëzu. Eh me metodat e mirëfillta ai mund ta shfrytëzon shpejtë atë fuqinë edhe me shpreh në art.

Unë jom mundu, edhe deri dikun kom pasë sukses me e shprehë sinqeritetin ndaj një pune, qoftë ajo natyrë e gjallë, qoftë ndonji... imajnum me ditë me shpreh, me ditë me e realizu (kollitet), ajo mund ta quaj si gjysë vepre me qenë afër publikut edhe me shku edhe ma larg, me qenë afër kritikut se ne. Ju thojsha studentëve, “Nëse ne vetëm bohëm rob të natyrës, objektit, atëherë shumë kadale mundemi me ecë përpara, shumë kadale mundemi me dhonë, me shfrytëzu edhe mundet m'u pasivizu mendja jonë, mendja juve atë fuqi që kemi mundemi me pasivizu nëse nuk e shfrytëzojmë”.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë sistemi i artit ka ekzistiu?

Xhevdet Xhafa: Arti ma shumë, arti i sotëm, arti bashkëkohor. Unë thashë më parë asnjherë s'kam konkuru por më kanë ftu, më kanë njoftë pak a shumë, ma kanë njoftë artin tim edhe më kanë njoftu. Kom marrë pjesë, më kanë vlerësu, kom përfitu guximin dhe atë vlerësim edhe ma shumë jom kyçur në veprimtarinë time që kom... e kom pa që atë, aftësitë e mia muj me i shfrytëzu me art.

Erëmirë Krasniqi: Ju thatë që ju kanë vlerësu, a ka pasë në atë kohë historian të artit ose kritik të artit në kohën kur keni punu ju?

Xhevdet Xhafa: Ku po mendoni, këtu?

Erëmirë Krasniqi: Në Kosovë edhe në Jugosllavi se po më intereson qysh ju kanë ftu nëpër ekspozitat e para qysh ka ndodhë ajo për një artist?

Xhevdet Xhafa: Po në ish—Jugosllavi ka pasë kritik të mirëfilltë, të sinqertë, por edhe ata kanë qenë të rrallë pak. Në Kosovë po ashtu kemi pasë disa kritik, por me kritikë pak a shumë jo aq të sinqertë, kritikë me shkru, edhe sot dinë me shkru mirëpo jo në lidhje me përmbajtje. Jo me vlerat e mirëfillta artistike. Mirëpo edhe te ne arti modern ka fillu pak me vonesë kuptohet se kemi qenë gjithnji të izoluemë, jo të përkrahun. Mirëpo, dalë kadale arti si art shumë ma shpejtë po ecë edhe ka ecë se sa lamitë tjera, se ne me art mundemi me përfaqësu një popull, një vend, me shkencë vështirë se arti është i lexushëm, i kuptushëm.

Erëmirë Krasniqi: A mundesh me na tregu qysh kanë qenë të '90—tat për juve, akademinë edhe artistat e Kosovës, qysh i keni kalu ju krejt ato, atë pjesë të randë?

Xhevdet Xhafa: Vitet e '90—ta ka qenë një ngjarje artistike muj me thonë këtu te ne, jonë organizu këto ekspozita të përbashkëta, jonë shkru fjalë të mira për këto ekspozita, kanë fillu m'u veçu disa individë normal që jonë pa vlerat e tyre, s'ka qenë si politika që ka qenë politikë klasore, shtetërore. Arti disi u përkrahë në ish—Jugosllavi edhe poashtu në Kosovë.

Erëmirë Krasniqi: Për '90—tat e pata fjalën kur ju kanë qitë prej universitetit edhe Galerisë edhe institucioneve tjera, qysh, çka ka ndodhë me art në atë kohë, të '90—tat?

Xhevdet Xhafa: Vitet e '90—ta ishte një atmosferë shumë e zyrtë në universitet, ndërprehet universiteti në gjuhën shqipe. Fillojmë me ligjërë nëpër shpija private, ishte një presion nga qeveria e atëhershme, po mendoj Serbisë, mirëpo prapë ishte një lëvizje ku u organizojshin ekspozita jo të mëdhaja, nëpër kafe, kafiqa, jo m'u organizu ndonji ekspozitë kështu me një atmosferë të lirë. Ishte e pamundur me organizu ekspozita, po mendoj të nivelit Kosovar, po mendoj që ka një përmbajtje. Ekspozita kishte me pasë se regjimi atëhershëm pak, ish—Jugosllav, ishte pak një presion jo në art, në politikë, mirëpo politika ndikonte edhe në jo zhvillimin e artit në Kosovë.

Erëmirë Krasniqi: E çfarë kuptimi kish arti në këtë kohë... çfarë kuptimi kish arti në këtë kohë kur nuk kishit as universitet, as Galeri, as... qysh e motivojshit ju studentin me studiu art?

Xhevdet Xhafa: Arti... u organizojshin disa ekspozita nëper lokale, kafiqa e kishin njëfarë afirmimi lokal, nuk kishte nxitje, një stimulim për artistë, se arti ishte i kufizum, nuk kishim marrëdhaje të mira me republikat tjera, ishim të mbyllur, si politika që ishte mbyllë edhe arti te ne. Shumë vështirë ka qenë me organizu ndonjë ekspozitë të madhe, me vlera, s'ishin kushtet atëhere. Nuk kishte përkrahje edhe nga të '90—tat po mendoj nga qeveria s'kishim përkrahje, stimulim për organizimin e ekspozitave, ishte një vetëfinancim për ndonji manifestim artistik.

Erëmirë Krasniqi: A ka ndërru arti juj në këtë kohë?

Xhevdet Xhafa: Si?

Erëmirë Krasniqi: Arti juj a ka ndërru në këtë kohë a ka, këto rrethana politike a kanë pasë ndikim edhe në juve edhe në punën e juj?

Xhevdet Xhafa Jo, jo s'ka pasë kurrëfarë ndikimi unë kom punu gjithnji, kom pasë vullnet me punu edhe qe. Ma pak kom ekspozu në kohën e fundit në botën e jashtme, si duket tash për tash politika po funksionon, po dominon. Aty këtu po organizohen këto ekspozita që menxi ka ardhë koha unë me ekspozu në Shqipëri vitin e ardhshëm edhe këtu te ne ndër artistë ka pasë njifarë barriere që normal te artistët është ajo farë mospërkrahja, xhelozia mirëpo gjithnji kom besu në veti se arti i mirëfilltë ecë, ka me shku ma tutje. Kujtoj në të ardhmen edhe shteti ynë duhet me përkrahë artin se e vetmja lami është që mundet me afirmu një popull, një komb, një shtet.